



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

**PROJEKTVENDIM**

Nr 2120, Datë 13. 02. 2026

**Për një shtesë në VKB nr.113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës Ministrisë Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr.592/1, datë 30.01.2026 “Transferim fondesh për financimin e shërbimeve të përkujdesit në nivel qarku dhe bashkie”, Kryetari i Bashkisë paraqet projektin përkatës Këshillit të Bashkisë;

**Për të vendosur :**

1. Miratimin e një shtese në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2026 në:
  - Gr.13, Prog.10430, Kap.1 Art.606 në shumën 2,744,443 lekë. Kodi i Produktit 91307AH.
2. Miratimin e përdorimit të fondit të akordura në:
  - Gr.13, Prog.10430, Kap.01, Art.606 në shumën 2,744,443 lekë, për mbulimin e shpenzimeve për paga në shumën 1,845,240 lekë, për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumën 308,155 lekë, për Honorare 480,700 lekë dhe trajnime për stafin e projekteve në shumën 110,348 lekë, konkretisht për projektin:
    - a- “Tungjatjeta jetë” fondi i akorduar të përdoret për paga në shumën 926,880 lekë, për sigurime shoqërore e shëndetësore në shumën 154,789 lekë dhe trajnime për stafin në shumën 90,331 lekë.
    - b- “Ofrimi i shërbimeve komunitare multifunksionale për kategoritë në nevojë” fondi i akorduar të përdoret për paga në shumën 918,360 lekë, për sigurime shoqërore e shëndetësore në shumën 153,366 lekë, për Honorare 480,700 lekë dhe trajnime për stafin e projektit në shumën 20,017 lekë.
3. Për zbatimin e vendimit ngakohet Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

**KRYETARI**

**Pjerin Ndreu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 2120/ Prot.

Lezhë, më 13 . 02 . 2026

**RELACION**

**LIDHUR ME PROJEKTVENDIMIN E PARAQITUR PËR NJË SHITESË NË VKB  
Nr.113, Datë 15.12.2025 “PËR MIRATIMIN E PBA-së 2026-2028 dhe BUXHETIT  
VJETOR 2026”**

Të nderuar këshilltarë,

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të mekanizmit të Fondit Social, me shkresën nr.592/1, datë 30.01.2026 “Transferim fondesh për financimin e shërbimeve të përkujdesit në nivel qarku dhe bashkie”, ka akorduar fondin në shumën 2,744,443 lekë për mbështetjen e projektit: “Tungjatjeta Jetë” në shumën 1,172,000 lekë dhe projektit: “Ofrimi i shërbimeve komunitare multifunksionale për kategoritë në nevojë” në shumën 1,572,443 lekë.

Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social ka paraqitur kërkesën dhe relacionin përkatës lidhur me përdorimin fondit të akorduar për vitin 2026.

Prandaj, për të mundësuar përdorimin e fondit të akorduar nga MSHMS për mbështetjen e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve të ngritura në kuadër të fondit social, ju kërkoj miratimin e përdorimit të këtij fondi, sipas detajimit të paraqitur në projektvendim.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI**

**Pjerin Ndreu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
Protokoli  
Kartelë shoqëruese e praktikës

I. Dërgues

Ministria Shëndetësive

Nr. 582/1 Prot., Datë 30. 01. 2026

II. Marrësi : Bashkia Lezhë Nr. 1482 Prot., Datë 02. 02. 2026

Përmbajtja : Transferim fondesh

III. Për t/u trajtuar nga : 1. FIJANCA

Datë \_\_\_ / \_\_\_ / 2026

2. \_\_\_\_\_

Shënim i Kryetarit \_\_\_\_\_

Afati kthimit të përgjigjes:  7 ditë  5 ditë  3 ditë  2 ditë  Urgjent (brenda ditës)

Firmë \_\_\_\_\_

IV. Marrë në dorëzim nga Drejtori Drejtorisë përkatëse \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_ / \_\_\_ / 2026

V. Për t/u trajtuar nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_ / \_\_\_ / 2026

Shënim i Drejtorit të Drejtorisë: \_\_\_\_\_

Firmë \_\_\_\_\_

VI. Marrë në dorëzim nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës KH. HAKAJ, Datë 02 / 02 / 2026

VII. Për t/u trajtuar nga Specialisti i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_ / \_\_\_ / 2026

Shënim i Përgjegjësit të Sektorit: Për mbajtjen e 25000 nga q.p. përgjigje - M. Polica

Firmë \_\_\_\_\_

VIII. Marrë në dorëzim nga Specialisti i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_ / \_\_\_ / 2026

Firmë \_\_\_\_\_

IX. Dorëzim i Eprorit porosites, Datë \_\_\_ / \_\_\_ / 2026

X. Shënim

AA, 02. 02. 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 592/1 Prot.

Tiranë, më 30/01/2026

Lënda: Transferim fondesh për financimin e shërbimeve të përkujdesit në nivel qarku dhe bashkie

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR ✓  
TIRANË

KËSHILLIT TË QARKUT \_\_\_\_\_


BASHKISË Lehtë \_\_\_\_\_

DEGËS SË THESARIT  
\_\_\_\_\_

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 87, datë 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026", Udhëzimit Nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave nr. 2, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", si edhe shkresës së Shërbimit Social Shtetëror nr. 822, datë 26.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 592, datë 27.01.2026, bashkëlidhur gjeni transferimin e fondit për financimin e shërbimeve të përkujdesit në nivel qarku dhe bashkie, deri në nivel artikulli dhe produkti.

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



MINISTRIA E SHËNDETESISË DHE MIREQENIES SOCIALE

Transferimi per Fondin social në nivel Qarku dhe Bashkië -ID7440532

Tabela 1 -Bashkië

Emri Qeverisës	Gr 13	Kodi I Institucionit	Emri I Institucionit	Kapitulli	Programi	Artikulli	Kodi , Dega , Thesaurit	Kodi I produktit	Debiti Vjetor
				SHTETESA					
035	13	2035001	Keshilli I Qarkut Tiranë	1	10430	6060000	3353	91307AH	365,479,338
048	13	2048001	Keshilli I Qarkut Elbasan	1	10430	6060000	0808	91307AH	119,282,553
109	13	2109001	Bashkia Elbasan	1	10430	6060000	0808	91307AH	42,581,592
042	13	2042001	Keshilli I Qarkut Berat	1	10430	6060000	0202	91307AH	7,739,727
037	13	2037001	Keshilli I Qarkut Vlorë	1	10430	6060000	3737	91307AH	8,326,956
146	13	2146001	Bashkia Vlorë	1	10430	6060000	3737	91307AH	18,272,931
141	13	2141001	Bashkia Shkodër	1	10430	6060000	3333	91307AH	7,800,929
119	13	2119001	Bashkia Rrezozhinë	1	10430	6060000	3513	91307AH	4,158,672
107	13	2107001	Bashkia Durres	1	10430	6060000	0707	91307AH	2,192,016
103	13	2103001	Bashkia Bulqizë	1	10430	6060000	0603	91307AH	7,943,569
110	13	2110001	Bashkia Gërnik	1	10430	6060000	0808	91307AH	1,334,400
111	13	2111001	Bashkia Fier	1	10430	6060000	0909	91307AH	983,162
114	13	2114001	Bashkia Gëmish	1	10430	6060000	0810	91307AH	1,372,800
654	13	2654001	Bashkia Klos	1	10430	6060000	625	91307AH	1,372,800
168	13	2168001	Bashkia Mirditë	1	10430	6060000	1515	91307AH	1,575,000
136	13	2136001	Bashkia Pogradec	1	10430	6060000	1529	91307AH	566,296
140	13	2140001	Bashkia Polican	1	10430	6060000	0232	91307AH	1,924,999
137	13	2137001	Bashkia Pukë	1	10430	6060000	3330	91307AH	1,473,120
139	13	2139001	Bashkia Selanite	1	10430	6060000	3737	91307AH	1,164,000
011	13	2011001	Keshilli I Qarkut Gjirokastrë	1	10430	6060000	1111	91307AH	19,936,094
020	13	2020001	Keshilli I Qarkut Lezhë	1	10430	6060000	2020	91307AH	29,431,972
117	13	2117001	Bashkia Lezhë	1	10430	6060000	2020	91307AH	2,744,443
102	13	2102001	Bashkia Berat	1	10430	6060000	0502	91307AH	1,164,000
122	13	2122001	Bashkia Korce	1	10430	6060000	1515	91307AH	3,946,724
104	13	2104001	Bashkia Dëkine	1	10430	6060000	3705	91307AH	1,206,368
105	13	2105001	Bashkia Devoll	1	10430	6060000	1505	91307AH	1,572,464
120	13	2120001	Bashkia Kolonjë	1	10430	6060000	1514	91307AH	1,636,800
130	13	2130001	Bashkia Malësi e Madhe	1	10430	6060000	3333	91307AH	802,500
125	13	2125001	Bashkia Kukes	1	10430	6060000	1818	91307AH	1,665,506
128	13	2128001	Bashkia Librazhd	1	10430	6060000	0821	91307AH	2,503,652
113	13	2113001	Bashkia Rrugovec	1	10430	6060000	0909	91307AH	1,023,000
152	13	2152001	Bashkia Bashi	1	10430	6060000	0808	91307AH	1,233,900
142	13	2142001	Bashkia Tepelene	1	10430	6060000	1134	91307AH	1,940,240
138	13	2138001	Bashkia Shtatë	1	10430	6060000	3731	91307AH	2,128,508
033	13	2033001	Keshilli I Qarkut Shkoder	1	10430	6060000	3333	91307AH	26,054,201
015	13	2015001	Keshilli I Qarkut Korce	1	10430	6060000	1515	91307AH	11,912,026
326	13	2326001	Bashkia Fiering	1	10430	6060000	3704	91307AH	930,400
124	13	2124001	Bashkia Kucove	1	10430	6060000	0217	91307AH	921,043
135	13	2135001	Bashkia Peme	1	10430	6060000	1128	91307AH	2,598,175
108	13	2108001	Bashkia Shijak	1	10430	6060000	0707	91307AH	2,726,009
499	13	2499001	Bashkia Pustec	1	10430	6060000	1515	91307AH	3,342,438
147	13	2147001	Bashkia Divjake	1	10430	6060000	0922	91307AH	2,160,592
165	13	2165001	Bashkia Vore	1	10430	6060000	3333	91307AH	10,461,350
001	13	1013141	Administrata e SHSSH	1	10430	6060000	3333	91307AH	365,479,338



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**  
**DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL**

Nr. 2084 Prot

Lezhë, më 12.02 2026

**MIRATOHET**

**KRYETARI**

Pjerin Ndreu

**LËNDA:** Kërkesë për përdorimin e fondit social nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

**Drejtuar:** Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, Bashkia Lezhë ✓

**KËRKESË**

Në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 5055/13 Prot., datë 29.12.2025, lidhur me financimin e ofrimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në kuadër të Fondit Social për vitin 2026, vijon financimi për vitin e gjashtë të projektit “Shërbimi lëvizës ‘Tungjatjeta jetë’ për fëmijët me aftësi të kufizuar” në Bashkinë Lezhë, në masën 30% të koston, në vlerën 1.172.000 lekë për vitin 2026.

Gjithashtu, në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 5055/34 Prot., datë 29.12.2025, për financimin e ofrimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në kuadër të Fondit Social për vitin 2026, vijon financimi për vitin e katërt të projektit “Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbimeve cilësore multifunkionale me bazë komunitare” në Bashkinë Lezhë, në masën 30% të koston, në vlerën 1.572.443 lekë për vitin 2026

**Kërkojmë:**

1- Miratimin e një shtese në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2026, si më poshtë:

1/1 Të shtohen burimet në Buxhetin e vitit 2026 me shumën 1.172.000 lekë, fond i cili është akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me shkresën nr. 5055/13 Prot, datë 29.12.2025.



1/2 Të shtohen burimet në Buxhetin e vitit 2026 shumën 1.572.443 lekë, fond i cili është akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me shkresën nr. 5055/34 Prot, datë 29.12.2025.

1/3 Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor si më poshtë:

Fondi të përdoret për:

Paga, në shumën lekë **926,880 lekë;**

Sigurime shoqërore e shëndetësore me shumën **154,789 lekë.**

- Trajnim për stafin e projektit 90,331 lekë.

Fondi të përdoret për:

Paga në shumën **918,360 lekë;**

Sigurime shoqërore e shëndetësore në shumën **153,366 lekë.**

Honorare, në shumën **418,000 lekë**

Tatim në burim, në shumën **62,700 lekë.**

- Trajnim për stafin e projektit 20,017 lekë.

Bashkangjitur gjeni dokumentet: shkresat përkatëse të ministrisë, me fondin social mbështetës për secilin projekt, preventivin e shpenzimeve, fishën e buxhetit, udhëzimin e ministrisë dhe relacionin vjetor të shërbimeve.

Konc: A. Zefi

**DREJTORI**

**Marte Fetaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL**

Nr. 2084/1 prot.

Lezhë: 12/02/2026

**Lënda:** Relacion vjetor i Qendres Komunitare Multifunkionale

**DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT**

**KËTU**

Zbatimi i projektit “Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbimeve cilësore multifunkionale me bazë komunitare, të fokusuar në fuqizimin, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të familjeve, të rinjve dhe fëmijëve në nevojë” ka vijuar punën rregullisht edhe gjatë këtij viti. Gjatë kësaj periudhe, të gjitha shërbimet dhe aktivitetet e planifikuara janë ofruar rregullisht, jo vetëm për përfituesit e drejtpërdrejtë të Qendrës, por edhe për anëtarë të tjerë të komunitetit.

Koordinimi dhe bashkëpunimi me Drejtorinë e Kujdesit dhe Shërbimit Social, si edhe me aktorë të tjerë relevantë për menaxhimin e përbashkët të rasteve sociale, ka qenë i vazhdueshëm, me synimin për të mbështetur sa më shumë qytetarë në nevojë dhe për të kontribuar në përmirësimin e situatës së tyre sociale. Po ashtu, bashkëpunimi me komunitetin dhe me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në Lezhë ka vijuar edhe gjatë kësaj periudhe raportimi, duke mundësuar ndërhyrje më të koordinuara, gjithëpërfshirëse dhe efektive për rastet që kanë nevojë për mbrojtje dhe mbështetje sociale.

***Shërbimet e ofruara në Qendrën Komunitare Multifunkionale përfshijnë:***

● **Shërbimi i passhkollorit**

Ky shërbim dhëhiqet nga dy mësueset e këtij programi, i cili i ndihmon fëmijët të kryejnë detyrat, të mësojnë dhe të argëtohen, duke zhvilluar edhe aftësi të rëndësishme për jetën në një mjedis të sigurt dhe mbështetës. Shërbimi u ofrohet fëmijëve që vijnë nga familje me dinamika të ndryshme sociale dhe ekonomike, për të cilët ky shërbim përbën një nevojë të domosdoshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Fokusi i programit të passhkollorit është zhvillimi i aftësive akademike dhe psiko-sociale. Fëmijët janë mbështetur në realizimin e detyrave të shtëpisë, përgatitjen e projekteve shkollore dhe përvetësimin e njohurive bazuar në kompetenca lëndore dhe ndër-ëndore.

Paralelisht me mbështetjen akademike, janë zhvilluar aktivitete të ndryshme social-kulturore, psiko-sociale dhe lëvizore, me qëllim nxitjen e zhvillimit të gjithanshëm të fëmijëve dhe rritjen e angazhimit të tyre aktiv. Brenda shërbimit të passhkollorit përfshihët edhe **shërbimi “Snack” për fëmijët**, i cili ka vazhduar të ofrohet rregullisht prej muajit tetor 2024 dhe nga janari 2025 ofrohet me fondet e Bashkisë Lezhë. Ky shërbim ka përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimit, duke iu ardhur ndihmë familjeve të fëmijëve, por edhe ka rritur kënaqësinë e fëmijëve gjatë frekuentimit të programeve të qendrës.

- **Shërbimi i pritjes, vlerësimit të nevojave dhe referimit**

Përgjatë këtij viti edhe ky shërbim është ofruar rregullisht, nga punonjësja sociale e NJVNR-së, e cila ka vijuar punën për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të familjeve që janë përfituese të qendrës, kryesisht familjet e reja të përfshira së fundmi në projekt. Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave është bërë në bazë të vizitave që janë bërë në familje, por edhe në bazë të intervistave individuale në familje dhe qendër, apo referimeve nga anëtarë të komunitetit, institucioneve apo OJF-ve të ndryshme. Pas kësaj procedure ka vijuar puna me menaxhimin e radteve sociale dhe monitorimin e situatave dhe problematikave në familje. Ka vijuar puna edhe me monitorimin e urdhrave të mbrojtjes, kjo e bërë në bashkëpunim me koordinatoren e dhunës në familje.

- **Këshillim psikologjik individual dhe në grup me fëmijë dhe të rritur**

Këshillimi psikologjik edhe gjatë këtij viti ka qenë një shërbim i kërkuar dhe i domosdoshëm për përfituesit. Shërbimi u është ofruar kryesisht fëmijëve që frekuentojnë qendrën, ndërsa rastet identifikohen përmes vëzhgimeve gjatë aktiviteteve në qendër, referimeve nga prindërit dhe mësueset e qendres. Këshillimet kanë vijuar edhe për rastet e referuara nga shërbimi social, por edhe rastet që vijnë nga vetë komuniteti, të cilët kanë kërkuar këshillim psikologjik. Këshillimet psikologjike realizohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat specifike të çdo rasti dhe ofrohen në mënyrë të vazhdueshme, me fokus mbështetjen emocionale, zhvillimore dhe psiko-sociale të fëmijëve dhe të rriturve.

Ky shërbim ndahet në:

- ***Këshillime individuale me fëmijët e qendrës/ Raste të referuara nga mësueset dhe punonjësja sociale***

Fëmijët që frekuentojnë qendrën janë nën monitorim të vazhdueshëm nga psikologjia dhe stafi dhe në varësi të situatës dhe dinamikave zhvillohen këshillime dhe ndërjegjësimë, Për këtë periudhë është zhvilluar këshillim individual me fëmijet që ndjekin programin e passhkollorit. Me këto raste janë zhvilluar seanca të vazhdueshme këshillimi psikologjik sipas dinamikave.



Këto këshillime lidhen kryesisht me probleme në sjellje, vështirësi në bashkëpunim, si edhe me marrëdhëniet me bashkëmoshatarët. Janë identifikuar edhe raste me problematika që burojnë jashtë ambienteve të qendrës, si në familje apo në shkollë. Paralelisht, po kryhet edhe *vlerësimi individual i statusit mendor dhe social* për çdo fëmijë të përfshirë në shërbimin pas shkollor. Pjesa më e madhe e problematikave zgjidhen vetëm me një seancë këshillimi, ndërsa rastet e tjera mbeten në ndjekje dhe monitorim të vazhdueshëm nga stafi dhe psikologjia.

- ***Këshillime në grup me fëmijët e qendrës***

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar disa këshillime në grup, të cilat kishin të bënin me problematika marrëdhëniesh mes grupit shoqëror dhe ndikimin e tyre në mbarëvajtjen e tyre në aktivitetet e qendrës.

- ***Këshillime me prindër***

Janë bërë këshillime të vazhdueshme edhe me prindërit e fëmijëve që frekuentojnë qendrën, për çështje që lidhen me sjelljet e tyre, problematikat e shfaqura gjatë programit të të nxënies apo në marrëdhënie me bashkëmoshatarët.

- ***Raste të referuara nga Shërbimi Social, Bashkia Lezhë***

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar edhe raste të referuara nga Shërbimi Social i Bashkisë Lezhë, duke ofruar mbështetje dhe ndjekje sipas nevojave të identifikuara.

• **Programi i aftësisimit prindëror**

Edhe për këtë vit janë organizuar takime me grupin e prindërve, që kanë si synim promovimin e Prindërimit Pozitiv. Këto takime kanë synuar mbështetjen e prindërve për të rritur vetëbesimin dhe aftësitë e tyre prindërore. Temat e zhvilluara për këtë vit janë: “Ushqyerja e shëndetshme dhe kequshqyerja te fëmijet”, “Vendosja e kufijve te fëmijët”, “Disiplinimi Pozitiv”, “Sfidat e fillimit të Vitit të ri shkollor, “Si të ruajmë balancën midis zhvillimit të shëndetshëm dhe teknologjisë”,

• **Aktivitetet ndërgjegjësuese dhe informuese për fëmijë, të rinj dhe familje**

Gjatë këtij viti janë zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese për fëmijë, të rinj dhe familje, me qëllim rritjen e njohurive, ndërgjegjësimit dhe mbështetjes për çështje të ndryshme, si: “Java e familjes”, “1 Qershori Dita e Fëmijëve”, “Dita e të drejtave të fëmijëve”, “16 Ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”, aktivitet festiv me rastin e Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri etj.

• **Aktivitetet dhe trajnime me të rinjtë**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Përgjatë kësaj periudhe me të rinjtë, nxënës të shkollës “Kolin Gjoka” janë trajtuar tema të ndryshme sociale informuese/ndërgjegjësuese për çështje që u përkasin dhe i prekin ata e sociale dhe edukative. Ky shërbim ju vjen në ndihmë edhe për zgjedhjen profesionale si formë e praktikës. Disa nga temat e zhvilluara janë: “Trafikimi i qenieve njerëzore”, “Sfidat e komunikimit”, “Parandalimi i bullizmit”, “Zhvillimi i vetëbesimit si çelës për suksesin profesional”, “Varësitë tek të rinjtë - si zhvillohen dhe si parandalohen” etj.

**Numri total i përfituesve:**

Numri i fëmijëve përfitues të shërbimit të këshillimit psikologjik: 45

Numri i të rriturve që marrin shërbimin psikologjik: 28

Numri i fëmijëve që frekuentojnë shërbimin e passhollorit: 53

Prindër pjesëmarrës në takime: 38

Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet ndërgjegjësuese dhe informuese: 110

Konc: A. Zefi

**DREJTORI**

**Marte Fetaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**  
**DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Lezhë: \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

**Lenda:** Relacion vjetor i Shërbimit Lëvizës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar

**DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT**

**KËTU**

Shërbimi lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar “Tungjatjeta jetë” në Bashkinë Lezhë është një projekt i fituar në kuadër të thirrjes së pare për një projekt propozim të programit të fondit social të hapur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky projekt është një program social që ofron shërbime të specializuara në shtëpi për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në zona të thella të vendit dhe shërbim social për familjarët e tyre. Filloi të zbatohet për herë të pare në Bashkinë Lezhë në prill të vitit 2020. Shërbimi Lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar në Bashkinë Lezhë është në vitin e gjashtë të zbatimit të tij. Ekipi i specialistëve ofron shërbim për fëmijët dhe familjarët e tyre që janë të përfshirë në projekt. Në fokus të këtyre shërbimeve janë shërbimi i fizioterapisë, logopedisë, terapi zhvillimi, shërbim psikologjik dhe mbështetje sociale sipas planit që specialistët kanë hartuar për secilin fëmijë dhe familjet e tyre, në varësi të nevojave dhe vështirësive që ato kanë.

**Numri total i përfituesve**

**55** - Fëmijë që marrin terapi çdo javë

**103** - Prindër të fëmijëve me AK, të cilët përfitojnë orientim, këshillim dhe mbështetje me shërbime sociale.

**30** - Anëtarë të Ekipit Teknik Multidisiplinar


**120** - Profesionistë që punojnë me fëmijet me AK (staf shërbimi social, staf qëdrash komunitare, staf Njësive Administrative, staf i Qendrave Shëndetësore, staf i Arsimit), të cilët rrisin kapacitetet mbi shërbimet për fëmijët me AK.

**2400** (për vitet 2020,2021,2022,2023) Fëmijë që frekuentojnë çerdhe/kopshte/shkolla (34 çerdhe/kopshte/shkolla), të cilët janë sensibilizuar me takime të ndryshme informuese nga stafi I shërbimit lëvizës,në të gjitha Njësitë Administrative.

**1400** Anëtarë komuniteti,të rinjë në të gjitha Njesitë Administrative të Bashkisë Lezhë (10 Njësi) të cilët do të marrin këshillim,mbështetje psikosociale,informim etj.

<b>Të rritur</b>		<b>Fëmijë</b>	
Femra	866	Femra	1323
Meshkuj	787	Meshkuj	1132
<b>Vulnerabiliteti</b>		<b>Vulnerabiliteti</b>	
Aftësi e kufizuar		Aftësi e kufizuar	220
Romë		Romë	-
Egjiptian	88	Egjiptian	120

Konc: L. Nikehasani



**DREJTORI**

**Marte Fetaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

Protokoli  
Kartelë shoqëruese e praktikës

I. Dërgues Ministria e Shëndetsi dhe Murgjenie Soc.  
Nr. 5055/Prot., Datë 29.12.2026  
13

II. Marrësi : Bashkia Lezhë Nr. 13 Prot., Datë 05.01.2026

Përbajtja : Mjofim

III. Për t/u trajtuar nga : 1. Sherb. Social Datë     /     /2026  
2. Finance

Shënim i Kryetarit \_\_\_\_\_

Afati kthimit të përgjigjes:  7 ditë  5 ditë  3 ditë  2 ditë  Urgjent (brenda ditës)

Firmë \_\_\_\_\_

IV. Marrë në dorëzim nga Drejtori Drejtorisë përkatëse \_\_\_\_\_, Datë     /     /2026

V. Për t/u trajtuar nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_, Datë     /     /2026

Shënim i Drejtorit të Drejtorisë: \_\_\_\_\_

Firmë \_\_\_\_\_

VI. Marrë në dorëzim nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_, Datë     /     /2026

VII. Për t/u trajtuar nga Specialisti i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_, Datë     /     /2026

Shënim i Përgjegjësit të Sektorit: \_\_\_\_\_

Firmë \_\_\_\_\_

VIII. Marrë në dorëzim nga Specialisti i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_, Datë     /     /2026

IX. Dorëzim i Eprorit porosites, Datë     /     /2026

Firmë \_\_\_\_\_

X. Shënim \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR MBROJTJEN SOCIALE  
DREJTORIA E POLITIKAVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE TË INTEGRUARA

Nr. 5055/Prot  
13

Tiranë, më 29.12.2025

Lënda: Njoftim

BASHKISË LEZHË ✓

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në përmbushje të detyrimeve ligjore, për të mundësuar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve të ngritura në kuadër të Fondit Social, ju njofton se:

Komisioni i vlerësimit të kërkesave, për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ka miratuar vijimin e financimit për vitin e shtatë të ofrimit të shërbimit të përkujdesit shoqëror "Shërbimi Lëvizës - Tungjatjeta Jetë" për fëmijët me aftësi të kufizuar" në bashkinë Lezhë, në kuadër të Fondit Social për vitin 2026.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale do të financojë vijimin e ofrimit të shërbimit në vitin e shtatë, në masën 30% të koston, në vlerën 1,172,000 lekë për vitin 2026. ✓

Njësia e vetëqeverisjes vendore ka detyrimin ligjor për të raportuar çdo katër muaj, lidhur me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, financuar nga Fondi Social, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në kuadër të bashkëpunimit kërkohet raportimi në kohë pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe të bëhet me dije Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Nga ana juaj kërkohet, që të gjitha strukturat përgjegjëse në administrimin tuaj, të kryejnë procesin e vlerësimit dhe referimit të rastit, në ofrimin e këtij shërbimi, nëpërmjet regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe raportimin e të dhënave çdo katër muaj. Mos përdorimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, do të kushtëzojë


Adresa: "Rruga e Kavajës", Tirana, Albania, Tel: +355 22 600 222, [www.shendetesia.gov.al](http://www.shendetesia.gov.al)

vijimin e financimit në kuadër të Fondit Social, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Gjithashtu, Bashkitë duhet të prioritizojnë trajtimin e rasteve të identifikuar dhe referuara nga Shërbimi Social Shtetëror.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

Protokolli  
Kartelë shoqëruese e praktikës

I. Dërgues Ministr. e Shënd Mirqenies Soc.  
Nr. 5055 / Prot., Datë 29. 12. 2026  
34

II. Marrësi : Bashkia Lezhë Nr. 12 Prot., Datë 05. 01. 2026  
Përbajtja : Mjoftrim

III. Për t/u trajtuar nga : 1. Shërb Social Datë / / 2026  
2. Financa

Shënim i Kryetarit \_\_\_\_\_

Afati kthimit të përgjigjes:  7 ditë  5 ditë  3 ditë  2 ditë  Urgjent (brenda ditës)  
Firmë \_\_\_\_\_

IV. Marrë në dorëzim nga Drejtori Drejtorisë përkatëse \_\_\_\_\_, Datë / / 2026

V. Për t/u trajtuar nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_, Datë / / 2026

Shënim i Drejtorit të Drejtorisë: \_\_\_\_\_

Firmë \_\_\_\_\_

VI. Marrë në dorëzim nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_, Datë / / 2026

VII. Për t/u trajtuar nga Specialisti i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_, Datë / / 2026

Shënim i Përgjegjësit të Sektorit: \_\_\_\_\_

Firmë \_\_\_\_\_

VIII. Marrë në dorëzim nga Specialisti i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_, Datë / / 2026

Firmë \_\_\_\_\_

IX. Dorëzim i Eprorit porosites, Datë / / 2026

X. Shënim \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR MBROJTJEN SOCIALE  
DREJTORIA E POLITIKAVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE TË INTEGRUARA

№ 5055/Prot  
134

Tiranë, më 29.12.2025

Lënda: Njoftim

BASHKISË LEZHË

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në përmbushje të detyrimeve ligjore, për të mundësuar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve të ngritura në kuadër të fondit social, ju njofton se:

Komisioni i vlerësimit të kërkesave për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ka miratuar vijimin e mbështetjes financiare në vitin e katërt të ofrimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror "Ofrimi i shërbimeve komunitare multifunkionale për kategoritë në nevojë", - përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbimeve cilësore multifunkionale me bazë komunitare në bashkinë Lezhë, në kuadër të Fondit Social 2026.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale do të financojë kontributin e kërkuar nga Fondi Social, në vitin e katërt të ofrimit të shërbimit, deri në 30% të koston së shërbimit, në vlerën 1,572,443 lekë për vitin 2026.

Njësia e vetëqeverisjes vendore ka detyrimin ligjor, për të raportuar çdo katër muaj, lidhur me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, financuar nga Fondi Social, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në kuadër të bashkëpunimit, kërkohet raportimi në kohë pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe të bëhet me dije Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale mbi zbatimin e projektit, si dhe përdorimin e regjistrit elektronik.

Nga ana juaj kërkohet, që të gjitha strukturat përgjegjëse në administrimin tuaj, të kryejnë procesin e vlerësimit dhe referimit të rastit, në ofrimin e këtij shërbimi, nëpërmjet regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe raportimin e të dhënave çdo katër muaj. Mos përdorimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, do të kushtëzojë

vijimin e financimit në kuadër të Fondit Social, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Gjithashtu, Bashkitë duhet të prioritetizojnë trajtimin e rasteve të identifikuara dhe referuara nga Shërbimi Social Shtetëror.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

